



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS PODUJEVË

Numri i lëndës: 2023:045863
Datë: 18.09.2024
Numri i dokumentit: 06173852

C.nr.581/2023

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA NË PODUJEVË, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni civil, me gjyqtarin Nazmi Neziri, duke vendosur në çështjen juridike kontestimore të paditësit A. J. nr. personal ..., nga P., të cilin e përfaqëson autorizuari avokatura “K. & A.” me avokatët e saj S. K. etj., nga P., U. C..., me autorizim, kundër të paditurës Komuna e Podujevës, Drejtoria Komunale për Arsim nga P., Rruga “N. G.” pn., baza e kontestit për Kompensimin e 70% të transportit rrugor-biletës, me vlerë kontesti: e papërcaktuar, jashtë seancës me datë 18.09.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

KONSTATOHET se është tërhequr padia e paditësit A. J. nr. personal ..., nga P., kundër të paditurës Komuna e Podujevës, Drejtoria Komunale për Arsim nga P., Rruga “N. G.” pn., baza e kontestit për Kompensim e shujtave.

Secili palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Gjykata lidhur me çështjen konkrete juridike pas shqyrtimit paraprak të padisë dhe shkresave të lëndës, konstaton se paditësi-i autorizuari i tyre me parashtresën e datës 03.09.2024, ka theksuar se njoftojmë gjykatën se paditësi e ka realizuar të drejtën e ngritur me padi, andaj për të njëjtën tërhiqemi dhe nuk kërkojmë kompensim.

Me nenin 261.1, të Ligjit Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore (LPK-së), është përcaktuar se: *“Paditësi mund ta tërheqë padinë pa pëlqimin e të paditurit deri në momentin në të cilin i padituri e paraqet në gjykatë përgjigjen në padi.”*, ndërsa me nenin 261.3 të njëjtit ligj është paraparë se: *“Po që se padia është tërhequr, gjykata jep aktvendim me të cilin konstatohet se është tërhequr padia. Ky aktvendim i dërgohet të paditurit vetëm po që se padia i është dorëzuar me parë.”*, kurse në nenin 261.4, thuhet se: *“Kundër aktvendimit me të cilin konstatohet se është tërhequr padia nuk lejohet ankimi.”*

Andaj, si rezultat i kësaj, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi e në mbështetje të nenit 261.1, 2 dhe 4 si dhe nenit 387.1 (c) dhe 450 të Ligjit Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore të Kosovës (LPK-së).

**Gjykata Themelore në Prishtinë-Dega në Podujevë, Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.581/2023 më datë 18.09.2024**

Gjyqtari:
Nazmi Neziri

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi nuk lejohet ankesa.